



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATË

E përpiluar me datën **17.06.2019** në Lipjan ndërmjet:

Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga drejtori i prokurimit Adem Duriqi (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë, dhe

"Bujar Shabani B.I" nga Ferizaj, që e përfaqëson Bujar Shabani, Drejtor (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara më poshtë:

"Ndërtimi i rrugës me trotuar, ndriqim publik në lagjen e Konjuhut rreth shtratit të Lumit Janjevka në Lipjan" me numër identifikues: 613 019 058 521

Neni 1 Lënda

Qëllimi i kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim: **"Ndërtimi i rrugës me trotuar, ndriqim publik në lagjen e Konjuhut rreth shtratit të Lumit Janjevka në Lipjan"** të gjitha të specifikuara te përshkrimi i çmimeve.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi përgjithshëm i punëve është: **129,797.55 €** apo shprehur me fjalë: njëqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë /euro/ e pesëdhjetë e pesë /centë/.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai është i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Rishikimi dhe ndryshimi i çmimeve nuk pranohet dhe do të paguhet vetëm shuma e cekur në nenin 2.1. Në rast se paraqiten pengesa të cilat duhet eliminuar patjetër për realizimin e projektit do të rregullohet me aneks kontratë.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

3.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

3.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbal i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Kontraktuesin

Emri:	Duat Reçica	Emri:	Bujar Shabani
Pozita:	U.D i drejtorit të prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	



PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga

marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastiit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuëse të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 8 Programi

8.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuëse të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuara, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

Neni 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere te nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përgjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Neni 13 Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftojë Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjojë defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

Neni 14 Paramasa dhe Parallogaria

14.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 15 Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara, me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 16 Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktajnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

Neni 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

Neni 20 Parapagimi

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 21 Mbajtja e Parasë

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kalojë periudha garantuuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

Neni 22 Siguria e ekzekutimit

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 23 Kostoja e Riparimeve

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose moshëprimet e Kontraktuesit.

Neni 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimi të punëve

24.1 Pasi që kryesisht të jenë përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftoj Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryej të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve të pranimi të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshoj Certifikatën e pranimi të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të jap instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimi të kësaj Certificate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

Neni 25 Llogaritja përfundimtare

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen ti paguhen Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshojë Certifikatën e periudhës garantuese të defekteve dhe do të certifikojë cilëndo pagese finale e cila duhet ti paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimi të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren të meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendos mbi shumën e cila do ti paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshojë certifikatën mbi pagesën.

Neni 26 Shkëputja e kontratës

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 27 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e

personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 29 Lirimi nga Ekzekutimi

29.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 30 Forca madhore

30.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejt që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni . Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është: Valzim Mziu, Nr tel 044-597 644
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë : 3 dite nga data e nënshkrimit te kontratës prej 20.06.2019 dhe do të zgjatë deri 18.08.2019 ose 60 ditë kalendarike
Plani dinamik		Plani dinamik nuk duhet të jetë më i gjatë se 60 ditë kalendarike nga hapja e ditarit të punës dhe çdo vonesë pa arsye më gjatë se plani dinamik i ofertuar do të konsiderohet shkelje e kontratës dhe do të zbatohen penalet
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periodha garantuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) në afat 1 vjeçar pas pranimit teknik dhe obligimi se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do ti sanojë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompenzim. Në të kundërtën pajtohet se AK ato dëme do ti sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do ti fakturojë Kontraktorit që ka dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve. Në rast të konzorciumit kjo deklaratë ipet në emër të liderit të konzorciumit.

Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë: <i>2 ditë pas nënshkrimit të kontratës</i>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <i>0.25 % e vlerës së kontratës/ për ditë.</i> Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <i>10 % e Çmimit final të Kontratës.</i>
Parapagimi	20.1	Shuma e Parapagimit është: <i>S'ka parapagim</i> Pagesat do të bëhen: sipas situacioneve të përfunduara në teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrijnë shumën 90% e mjeteve të paguara. Pjesa e mbetur për pagesë prej 10% do t'i paguhet kontraktuesit pas pranimit teknik të punëve
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% e mjeteve do të mbahen deri në pranimin teknik, ndërsa pas pranimit teknik të punëve kontraktuesi do të sjellë sigurimin e garancionit të punëve në afat prej 12 muajve me të cilat do të përdoren për përmirësimin e defekteve nëse paraqiten gjatë kësaj kohe e kontraktuesi nuk përgjigjet
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : <i>10 % e vlerës së kontratës, ose 12,979.75€ e cila duhet të paguhet me rastin e nënshkrimit të kontratës në kohëzgjatje prej 90 ditëve.</i>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shumën e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	<i>Komisioni përbrenda Komunës, ose deri në instancën më të lartë që do të përbëhet nga drejtori i shërbimeve publike, drejtori i prokurimit dhe drejtori i Planifikimit dhe urbanizëm</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	<i>[shëno te dyja]</i> Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Ekonomike në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

**Paramasa -Ndërtimi i rrugës me trotuar, ndriqim publik në lagjen e Konjuhut
rreth shtratit të lumit Janjavka në Lipjan**

L=1+159.00 km

Nr. rendor	Lloji i punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
------------	---------------	--------	-------	--------------------	--------------------

1 PUNËT PARAPRAKE

1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë, Pergaditja e puntoreve dhe komplet plani per ekzekutimin e kti projekti.	m'	1,159.00	0.10	115.90
1.2	Shenimi i trasesë para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit te punimeve.	m'	1,159.00	0.10	115.90

Gjithsej: 231.80€

2 PASTRIMI I TERENIT

2.1	Pastrimi I trases nga drunjet me dijametra te ndryshem, shkurret, betonay dhe gjesendet tjera qe e pengojn ekzekutimin e rrugës. Qmimi komplet per gjatesi te trases.	m'	1,159.00	0.40	463.60
2.2	Dislokimin e shtyllave ekzistuese dhe zevendesimin e tyre me shtylla te betonit me lartesi H=9m kendore tip 40°, me bazament te betonit duke perfshire germimin per bazament me dimensione (1.0x1.0x1.5)m, vendosjen e betonit, shiritin e tokezimit Fe/Zn 25x4mm (3.5m), reren e imet , montimi i unazes , vendosja e konzolles (per rrjet ajror 0.4kV) .	copë	2.00	300.00	600.00
2.3	Demontimi dhe montimi i kabllave ekzistuese ajrore dhe nentokesore eventuale dhe materiali tjetër i nevojshem komplet me ateste per nje shtylle te dislokuar.	copë	2.00	50.00	100.00
2.4	Te rregullohen ngihen ne nivelin e ri pusetat ekzistuese para ekzekutimit të shtrese se asfaltit dhe trotuarit. Në qmim te kalkulohet Konusi Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara) dhe kapaku nga material metalik gize, pesha mbajtese 15tona.	copë	8.00	120.00	960.00

Gjithsej: 2,123.60€

3 PUNIMET E DHEUT

3.1	Gërmimi i dheut te kategoris III,IV dhe V me ngarkim dhe bartje ne gjatesi 15 km .Sasia e llogaritur ne gjendje natyrale.	m³	4,103.34	0.90	3,693.01
3.2	Rrafshimi i nënbazës me ngjeshje dhe vibrocilinder deri ne 35 N/mm² .	m²	9,040.00	0.10	904.00
3.3	Punimi i mbushjeve me material cilesor per mbushje sipas standardeve per mbushje. Ne qmim te kalkulohet furnizimi transporti si dhe ngjeshja deri ne 35 N/mm² .	m³	2,394.43	1.90	4,549.42
3.4	Hapja e kanaleve anësore ne form trapezi sipas projektit, për qarkullimin e ujrave. Në qmim te kalkulohet Germimi dhe largimi I dheut 15km si dhe formësimi I kanaleve. Komplet per gjatësi te kanalit.	m'	1,159.00	0.40	463.60
3.5	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm .Sasia e llogaritur 7cm për gjerësi te bankinave 50 cm ne gjendje te ngjeshur.	m³	120.00	5.00	600.00

Gjithsej: 10,210.02€

4 PUNËT E LËSHESAVE					
4.1	Punimi i lëshesës gypore me :Furnizimi ,bartja dhe montim te gypave nga betonarmeja Ø400mm per qarkullim te ujit nga njera ane e rrugës ne tjetren.Ne qmim te kalkulohen germimi i dheut me largim, mbulim me zhavor (0-31.5) dhe kokat hyrese dhe dalese me beton C-25/30 Armatura rrjet Ø8-10/10cm. Qmimi per cop i komplet lëshesës me gjatesi L=8.5 m'.	copë	6.00	119.00	714.00
4.2	Punimi i lëshesës gypore ne rruget lidhese :Furnizimi ,bartja dhe montim te gypave nga betonarmeja Ø300mm per qarkullim te ujit nga njera ane e rrugës ne tjetren.Ne qmim te kalkulohen germimi i dheut me largim, mbulim me zhavor (0-31.5) dhe kokat hyrese dhe dalese me beton C-25/30 Armatura rrjet Ø8-10/10cm. Qmimi per cop i komplet lëshesës me gjatesi L=6 m'.	copë	7.00	72.00	504.00
4.3	Furnizimi transporti si dhe vurma ne veper e ujmbledhsave. Ne qmim te kalkulohen: Germimi si dhe mbulimi me zhavor. Gypi betonarme Ø400/500mm me bazament betoni dhe ne grill. Grilla metalike 40/40 cm per peshat t=40ton . Gypi I brinjzuar PE SN8 Ø 250mm L=7m'. Koka shkarkuese betonarme C-25/30. Te kalkulohen komplet punet sipas standardeve.	copë	20.00	115.00	2,300.00
Gjithsej:				3,518.00€	

5 MBISËTRUKTURA

5.1	Furnizimi ,planifikimi dhe ngjeshja e materialit guror me diameter 0-125mm .Gjate planifikimit rruges t'l ipet trashesia e shtreses t=45cm sasia ne gjendje te ngjeshur deri ne 60 N/mm².	m³	2,472.00	2.30	5,685.60
5.2	Furnizimi ,planifikimi dhe ngjeshja e materialit guror me diameter 0-63mm .Gjate planifikimit rruges t'l ipet trashesia e shtreses t=20cm rruga dhe t=25cm trotuari sasia ne gjendje te ngjeshur deri ne 60 N/mm².	m³	1,989.00	4.70	9,348.30
5.3	Furnizimi ,planifikimi dhe ngjeshja e materialit guror me diameter 0-31.5mm .Gjate planifikimit rruges t'l ipet trashesia e shtreses t=10cm sasija ne gjendje te ngjeshur deri ne 80 N/mm².	m³	942.00	5.20	4,898.40
5.4	Furnizimi, transporti, vendosja dhe betonimi i skajoreve 18/24 .Skajoret do te punohen pergjat asfaltit ekzistues.	m'	1,200.00	6.00	7,200.00
5.5	Furnizimi, transporti, vendosja dhe betonimi i skajoreve 8/20 .	m'	1,200.00	3.00	3,600.00
5.6	Furnizimi, transporti dhe punimi i trotuareve me kubëza betoni t=8cm, forma kubëzave të caktohen nga organi mbikqyrës. Në cmim të llogariten, planifikimi i nënbazës me ngjeshje, zhavor (4-8) t=5cm te nivelizohet, si dhe kubzat me ngjeshje dhe mbushje te fugave.	m²	1,750.00	6.50	11,375.00
5.7	Furnizimi dhe punimi i shtresës së Asfaltbetoni 0-16 mm me trashësi t=7 cm, dhe ngjeshja sipas standardeve per ket lloj pozicion. Ne qmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve per ket pozicion.	m²	5,900.00	6.40	37,760.00

5.8	Hartimi I projekti detal nga ana e kompanise, pas perfundimit te projektit "ASB Drawing", duke perfshi te gjitha elemente percjellse te niveletes situacion, gjatsot, terthor, diagrami I mbushjeve, diagrami I germimeve, kordinatat poligonale etj).	m'	1,159.00	0.30	347.70
Gjithsej:					80,215.00€

6 LËSHESA PLLAKORE

6.1	Shenimi dhe piketimi i lesheses pllakore si dhe percjellja e niveletes gjate punimit.	copë	1.00	50.00	50.00
PUNIMET E DHEUT					
6.2	Gërmimi i dheut te kategoris III dhe IV me ngarkim dhe bartje ne deponi ne gj,m 5.0 km	m³	150.00	1.00	150.00
6.3	Përpunimi I shtratit të përroit ne gjatëse 30m para dhe pas lëshesës, në cmim përfshihet gërmimi i dheut formesimi I skapateve mbushja sipas nevojës	copë	1.00	200.00	200.00
PUNIMET E BETONIT					
6.4	Transporti, furnizimi dhe betonimi i themeleve, shtyllave ballore me krihë, trareve, soletes kaluese, pllakave kapërcyese te klases C-25/30. Në cmimi hyn edhe kallupimi.	m³	56.00	70.00	3,920.00
6.5	Transporti, furnizimi dhe vendosja e betonit te varfer C-12/15 t=10cm nen tabanin e themeleve, mbi hidroizolimin mbi soleton, si dhe nen pllakat kulluese	m³	4.00	60.00	240.00
6.6	Rrafshimi i nënbazës se themeleve me ngjeshje 30 MPa	m²	53.00	0.50	26.50
6.7	Transporti, furnizimi i tamponit nga guri i thyer gelqeror 0-60 mm per punim e baze the shputave te themeleve. Shtresa t=50cm ngjeshje 80 MPa	m³	27.00	6.00	162.00
6.8	Transporti, furnizimi dhe punimi i bredhit drenazhues me zhavor ne thase te fraksionit IV (afër mureve te vendoset ne thase prej rrjete)	m³	20.00	10.00	200.00
6.9	Shtresa e argjilës të ngjeshur nën gypin e drenazhit	m³	25.00	5.00	125.00
6.10	Transporti, furnizimi dhe vendosja i Gypave PVC te perforuar për drenazhim Ø200	m'	16.00	4.00	64.00
6.11	Transporti, furnizimi dhe punimi i parrakeve metalik (tubat kryesor prej celiku me diamter 6cm dhe me trashësi t=3mm, ndersa mbushjet me diameter 4cm dhe trashesi t=3mm, te gjithë tubat e celikut duhet te lyhen me dy shtresa anti korrozion dhe me ngjyre te metalit.	m'	17.00	50.00	850.00
6.12	Transporti, furnizimi dhe punimi armatures per soleten e lesheses pllakore	kg	4,620.00	0.65	3,003.00
6.13	Transporti, furnizimi dhe punimi i hidroizolimit dy shtresor te lesheses pllakore . Condor 2x4mm ose I ngjajshem	m²	215.00	5.00	1,075.00
Gjithsej:					10,065.50€

7 PUNËT E NDRIQIMIT

7.1	Mihja e kanalit me dimensione 0.4x0.8m në dheun e kategorisë së tretë për vendosjen e kabllor furnizuese PP00 Al 4x25mm, nga kuadröt shperndares deri tek shtyllat, si dhe largimi i dheut komplet nga trotuari dhe bartja e tij deri në deponin 15km e caktuar nga organi mbikqyres. Duhet te mirret parasysh se thellesia e germimit te kanalit eshte 80cm pasi qe pjesa prej 30cm eshte e parapar te germimi tek punet ndertimore.	m ³	398.42	1.50	597.63
7.2	Sigurimi ,transporti dhe vendosja e zhavorit 0-4 në kanal, ashtu që së pari të ndërtohet baza prej 10 cm, ndërsa pas montimit të gypit të hudhet rëra për rreth dhe 10cm mbi gyp.	m ³	135.00	7.00	945.00
7.3	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te galvanizuara ,shtyllat duhet te jene ortogonale ose rrethore me konzole njëkrahëshe komplet me anker dhe pllaken e araldit,lartesia e shtyllave te jete 5m,shtyllat duhet te jene te prodhuara sipas standardeve EN40,të galvanizuara sipas BS EN1461:1999, Te ngjajëshme me ato ekzistuese.	cope	47.00	180.00	8,460.00
7.4	Furnizimi dhe montimi i trupave ndriçuese LED 50W. E ndërtuar nga aliazhe alumini, e fortë,e vrazhdë, rezistent ndaj gërvishtjeve dhe goditjeve me mbyllje silikone. Tensioni: 90-264V (50 - 60Hz), Color temperature: 6000K Efikasiteti i ndriçueshmerisë: 3000 lm Jetëgjatësia: 50000 orë,Këndi i montimit 120/15 shkallë, Mbrojta nga lagështia: IP65, Mbrojta mekanike: IK10 Klasa e sigurisë: I Certifikimi: CE, C-tick, RoHS, PSE, ISO90012008 Poashtu drita duhet të plotësoj EN60598 - 1:2008 dhe EN60598 - 2 - 3:2003 Garancioni: 5 vite.	cope	47.00	50.00	2,350.00
7.5	Furnizimi dhe vendosja e gypit PVC Ø63 për kabllon furnizuese	m'	1,450.00	1.00	1,450.00
7.6	Furnizimi dhe vendosja e kabllor furnizuese PPOO Al 4x25mm ² për ndriçim publik	m'	1,300.00	3.10	4,030.00
7.7	Furnizimi dhe vendosja e kabllor kryesore furnizuese PPOO Al 4x35mm ² prej trafos deri te kuadri kryesorë shpërndarës i ndriçimit	m'	150.00	3.80	570.00
7.8	Furnizimi dhe montimi i kabllor Cu 3x2.5mm ² për lidhjen e dritës me furnizimin, kablo e cila vendoset mbrenda trupit ndriques.	m'	376.00	1.00	376.00
7.9	Betonimi dhe armimi I bazamentit të shtyllave me dimensione te bazamentit 60x30x30cm me beton te tipit MB30	cope	47.00	20.00	940.00
7.10	Furnizimi dhe vendosja e shiritit për tokzim Fe/Zn 25*4mm	m'	1,460.00	1.50	2,190.00

7.11	Porositja , furnizimi transporti dhe shtrirja e mbrojtëses mekanike të kablove tip GAL, dhe i shiritit paralajmerues "RREZIK TENSIONI" përgjatë gjatësisë së kanalit.	m'	1,460.00	0.20	292.00
7.12	Ndërtimi i bazamentit të betonit për KKSH të ndriqimit me dimensione 80x90x60cm	copë	1.00	300.00	300.00
7.13	Bartja dhe montimi i kuadrove furnizuese, të punuar nga llamarina e dekapiruar me këto karakteristika: 700x1420x200 mm, trashësia e llamarinës 2mm, me dy dyer, me mundësi të mbylljes me dry, një hyrje dhe katër dalje të realizuara me puthitës special për mbrojtje nga lagështia dhe përforsim mekanik,	copë	1.00	200.00	200.00
7.14	Furnizimi dhe montimi i nderprersit 160A 1-0-2	copë	1.00	10.00	10.00
7.15	Furnizimi dhe montimi i siguresave thikore 63A, për kabllon furnizuese.	copë	3.00	30.00	90.00
7.16	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 20A	copë	4.00	3.00	12.00
7.17	Furnizimi dhe montimi i sensorit për kyqje dhe nderprerje të rrjetit të ndriqimit.	copë	1.00	5.00	5.00
7.18	Furnizimi dhe montimi i kontaktorit 100A	copë	1.00	100.00	100.00
7.19	Sonda përtokëzuese Ø75mm/1500mm	copë	4.00	10.00	40.00
7.20	Furnizimi transporti si dhe montimi i siguresave 16A ne shtyllat e ndriqimit.	copë	47.00	3.00	141.00
7.21	Furnizimi transporti si dhe vendosja e lidhjeve vazhduese te kabllit AL-CU (4) ne shtylla.	copë	47.00	5.00	235.00
7.22	Montimi i kablove ne trafostacionin ekzistuese.	copë	1.00	100.00	100.00
Gjithsej:					23,433.63€

REKAPITULLIMI

1	PUNËT PARAPRAKE				231.80
2	PASTRIMI I TERENIT				2,123.60
3	PUNIMET E DHEUT				10,210.02
4	PUNËT E LËSHESAVE				3,518.00
5	MBISTRUKTURA				80,215.00
6	LËSHESA PLLAKORE				10,065.50
7	PUNËT E NDRIQIMIT				23,433.63
Totali me TVSH:					129,797.55